



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 18

2002

Maj

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.8888, datë 25.4.2002	Për ratifikimin e “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”.....	553
Ligj nr. 8889, datë 25.4.2002	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995; nr.8286, datë 16.2.1998; nr.8392, datë 2.9.1998; nr.8575, datë 3.2.2000; nr.8776, datë 26.4.2001 dhe nr.8852, datë 27.12.2001.....	575
Vendim i KM nr. 194, datë 9.5.2002	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike dhe shërbimit.....	581

Vendim i KM nr. 195, datë 9.5.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr. 30, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e zgjedhjes dhe rregullimin e marrëdhënieve të shoqërive që do të ndërtojnë dhe përdorin instalime bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre".....	582
Vendim i KM nr. 196, datë 9.5.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 510, datë 24.11.1997 të Këshillit të Ministrave "Mbi kriteret e vendosjes në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranim".	583
Vendim i KM nr. 197, datë 9.5.2002	Për miratimin e Marrëveshjes për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike, të shërbimit dhe ato speciale ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit.....	584
Vendim i KM nr. 199, datë 9.5.2002	Për miratimin e anekskontratës për hidrocentralin e Smokthinës ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë italiane "ESSEGEI", S.R.L....	586
Vendim i KM nr. 205, datë 9.5.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr. 384, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e të miturve në punë".....	587

L I G J
Nr. 8888, datë 25.4.2002

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS PËR KRIMIN NË FUSHËN E KIBERNETIKËS”

Në mbështetje të neneve 78 pika 1, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa për krimin në fushën e kibernetikës”, me rezervën e parashikuar në këtë ligj.

Neni 2

Në mbështetje të nenit 42 të “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën për të mos parashikuar përgjegjësi penale, në rrethana të kufizuara, sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 10, me kusht që të parashikohen zhdëmtime të tjera, të cilat nuk shmangin përgjegjësinë ndaj dëmit të shkaktuar dhe nuk e shmangin Republikën e Shqipërisë nga detyrimet ndërkombëtare të parashikuara në instrumentet ndërkombëtare, përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të nenit të lartpërmendur.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3322, datë 3.5.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

PROJEKTKONVENTË MBI KRIMIN KIBERNETIK
PREAMBULA

Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës dhe pas kësaj, shtetet e tjera nënshkruese:

Duke konsideruar që qëllimi i Këshillit të Europës është që të arrihet një unitet sa më i madh ndërmjet anëtarëve të tij;

Duke njohur vlerën e nxitjes së bashkëpunimit me shtetet e tjera, Palë të kësaj Konvente;

Të bindur për nevojën e ndjekjes në mënyrë prioritare së një politike të përbashkët penale, që ka për qëllim mbrojtjen e shoqërisë nga krimi kibernetik, ndërmjet të tjerash me adaptimin e një legjislacioni të përshtatshëm dhe nxitjen e një bashkëpunimi ndërkombëtar;

Të ndërgjegjshëm për ndryshimet e thella të sjella nga digjitalizimi, konvergjenca dhe globalizimi i vazhdueshëm i rrjeteve kompjuterike;

Të shqetësuar nga rreziku që rrjetet kompjuterike dhe informacioni kompjuterik mund të përdoret gjithashtu për kryerjen e veprave penale dhe faktet e lidhura me këto vepra mund të memorizohen, të ruhen dhe të transferohen nëpërmjet këtyre mjeteve;

Duke njohur nevojën për bashkëpunim ndërmjet Shteteve dhe industrisë private në luftimin e krimit kibernetik dhe nevojën për të mbrojtur interesat ligjitime në përdorimin dhe zhvillimin e teknologjive të informacionit;

Duke besuar që një luftë efektive kundër krimit kibernetik kërkon një bashkëpunim ndërkombëtar të gjerë, të shpejtë dhe efektiv në çështjet penale;

Të bindur që Konventa aktuale është e nevojshme për të frenuar veprimet e drejtuara kundër konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë të sistemeve kompjuterike, rrjeteve dhe të dhënave kompjuterike, sikurse dhe keqpërdorimit të këtyre sistemeve, rrjeteve dhe të dhënave, nëpërmjet sigurimit që kjo veprimtari e tillë të kriminalizohet, sikurse përshkruhet në këtë Konventë, dhe nëpërmjet krijimit të forcave të mjaftueshme për luftimin efektiv të këtyre veprave kriminale, duke lehtësuar zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre veprave penale në të dyja nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe duke siguruar marrëveshjet për bashkëpunim ndërkombëtar të shpejtë dhe të besueshëm;

Duke menduar mbi nevojën për të siguruar një balancë të përshtatshme ndërmjet interesave të zbatimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave themelore të njeriut, sikurse është parashikuar në Konventën e Këshillit të Europës të vitit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Marrëveshja Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara të vitit 1966 mbi të Drejtat Civile dhe Politike, sikurse dhe traktatet e tjera ndërkombëtare të aplikueshme mbi të drejtat e njeriut, të cilat riafirmojnë të drejtën e çdokujt për të pasur opinione pa ndonjë ndërhyrje, sikurse dhe të drejtën e lirisë së shprehjes, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar, për të marrë dhe për të dhënë informacion dhe ide të të gjitha llojeve, pa marrë parasysh kufijtë dhe të drejtat që përfshijnë respektimin e fshehtësisë;

Duke menduar, gjithashtu, për mbrojtjen e të dhënave personale, sikurse janë parashikuar p.sh. në Konventën e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me Procesimin Automatik të të Dhënave Personale;

Duke konsideruar Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1989 mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventën e Organizatave Ndërkombëtare të Punës mbi Format më të këqija të punës së fëmijëve;

Duke marrë në konsideratë konventat ekzistuese të Këshillit të Europës mbi bashkëpunimin në fushat penale sikurse dhe traktatet e ngjashme, që ekzistojnë ndërmjet Shteteve anëtare të Këshillit të Europës dhe shteteve të tjera, dhe duke theksuar që Konventa aktuale ka për qëllim t'i shtohet këtyre konventave, në mënyrë që t'i bëjë më efektive hetimet kriminale dhe gjykimet që përfshijnë veprat penale të lidhura me të dhënat dhe sistemet kompjuterike dhe të mundësojë mbledhjen e fakteve në formë elektronike të veprave penale;

Mirëpritja e zhvillimeve të fundit, të cilat avancojnë më tej mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në luftimin e krimit kibernetik, duke përfshirë veprimet e Kombeve të Bashkuara, të OECS-së, Bashkimit Europian dhe të G-8-ës;

Duke rikujtuar rekomandimin Nr. R (85) 10, që përmban aplikimin praktik të Konventës Europiane mbi Asistencën e dyanshme në Çështjet Penale, në përputhje me letërporositë mbi interceptimin e telekomunikacioneve, Rekomandimin Nr. R (88) 2 mbi piraterinë në aspektet e të drejtës së autorit dhe të drejtave të fqinjësisë, Rekomandimi Nr. R (87) 15, që rregullon përdorimin e të dhënave personale në sektorin e Policisë, Rekomandimin Nr. R (95) 4 mbi mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e shërbimeve të telekomunikacionit, me referencë të veçantë në shërbime telefonike, sikurse dhe Rekomandimin Nr. R (89) 9 mbi krimet e lidhura me kompjuterat, duke dhënë udhëzimet për legjislaturat kombëtare përsa i përket përcaktimit të krimeve kompjuterike të caktuara dhe rekomandimin Nr. R (95) 13, përsa i përket problemeve të ligjit të procedurës kriminale lidhur me teknologjinë informative;

Duke pasur parasysh Rezolutën Nr.1, të adaptuar nga Ministrat Europianë të Drejtësisë në Konferencën e tyre të 21-të (Pragë qershor 1997), e cila i rekomandoi Komitetit të Ministrave të mbështesin punën e kryer nga Komiteti Europian për Problemet e Krimeve (CDPC) mbi Krimin Kibernetik, në mënyrë që të sillnin dispozitat e ligjit penal vendas më afër njëri-tjetrit dhe të mundësonin përdorimin e mjeteve efektive të hetimit, që përfshinin vepra penale të tilla, sikurse dhe Rezolutën Nr.3, të adaptuar në Konferencën e 23-të të Ministrave Europianë të Drejtësisë (Londër, qershor 2000), e cila inkurajonte Palët negociuese, që të vazhdonin përpjekjet e tyre në dritën e gjetjes së zgjidhjeve të përshtatshme, në mënyrë që të mundësohej një numër mundësisht sa më i madh shtetesh që të bëheshin Palë në Konventë dhe njohu nevojën për një sistem ndërkombëtar të bashkëpunimit të shpejtë dhe eficient, i cili merr parasysh në kohën e duhur kërkesat specifike në luftën kundër krimit kibernetik;

Duke pasur gjithashtu parasysh Plan-Veprimin e adaptuar nga Kryetarët e Shteteve të Këshillit të Europës, në rastin e Samitit të tyre të Dytë (Strasburg 10-11 tetor 1997), për të kërkuar përgjigje të përbashkët në zhvillimin e teknologjive të reja të informacionit, bazuar në standardet dhe vlerat e

Këshillit të Europës;
Kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI 1 PËRDORIMI I TERMAVE

Neni 1 **Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) “Sistem kompjuterik” do të thotë çdolloj pajisje apo grup i ndërlidhur ose pajisje të lidhura, një ose më shumë prej të cilave, vazhduese të një programi kryejnë procesime automatike të të dhënave.

b) “Të dhëna kompjuterike” do të thotë çfarëdolloj përfaqësimi të fakteve, informacioni apo konceptesh në një formë të përshtatshme për procesim në një sistem kompjuterik, që përfshijnë një program të përshtatshëm për punën e një sistemi kompjuterik për të kryer një funksion;

c) “Dhënës shërbimesh” do të thotë:

(i) çfarëdo entiteti publik apo privat, që i siguron shërbimin e tij përdoruesve, me mundësinë për të komunikuar nëpërmjet një sistemi kompjuterik; dhe

(ii) çfarëdo entiteti tjetër, që proceson apo memorizon të dhëna kompjuterike në të mirë të një shërbimi të këtillë komunikimi apo të përdoruesve për këtë shërbim.

d) “Të dhëna trafiku” do të thotë çdolloj të dhënash kompjuterike, të lidhura me komunikimin nëpërmjet një sistemi kompjuterik të prodhuara nga një sistem kompjuterik që përfaqëson një pjesë në zinxhirin e komunikimit, duke treguar origjinën e komunikimit(eve) destinacionin, rrugën, kohën, datën, përmasat, kohëzgjatjen apo tipin e shërbimit të poshtëshënuar.

KREU II MASAT QË DUHEN TË MERREN NË NIVELIN KOMBËTAR

SEKSIONI 1 LIGJI PENAL LËNDOR

TITULLI 1 VEPRAT PENALE KUNDËR KONFIDENCIALITETIT, INTEGRITETIT DHE DISPONUESHMËRISË TË TË DHËNAVE DHE SISTEMEVE KOMPJUTERIKE

Neni 2 **Hyrjet e paligjshme**

Çdo Palë adapton legjislacion të tillë dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim hyrja në një pjesë apo në tërësi të një sistemi kompjuterik pa të drejtë. Një Palë mund të kërkojë që vepra të jetë kryer nga shkelje e masave të sigurimit, me qëllimin e përfuturit të të dhënave kompjuterike ose qëllimet e tjera të pandershme ose në marrëdhënie me një sistem kompjuterik që është i lidhur me një sistem tjetër kompjuterik.

Neni 3 **Interceptimi i paligjshëm**

Çdo Palë do të adaptojë legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim interceptimi pa të drejtë, kryer me mjete teknike, të transmetimeve jopublike të të dhënave kompjuterike, nga ose brenda një sistemi kompjuterik, duke përfshirë emitime elektromagnetike nga një sistem kompjuterik që mbart të këtilla të dhëna kompjuterike. Një Palë mund të kërkojë që vepra të jetë shkaktuar me qëllim të

pandershëm ose në marrëdhënie me një sistem kompjuterik që është i lidhur me një sistem tjetër kompjuterik.

Neni 4

Interferenca e të dhënave

1. Çdo Palë duhet të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim dëmtimi, fshirja, shtrembërimi, ndryshimi, apo shuarja e të dhënave kompjuterike pa të drejtë.

2. Një Palë mund të rezervojë të drejtën të kërkojë që veprimi i përshkruar në paragrafin 1 të shkaktojë dëmtime serioze.

Neni 5

Interferenca e sistemeve

Çdo Palë do të adaptojë legjislacionin të tillë dhe masat të tjera që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim, pengesat serioze pa të drejtë të funksionimit të një sistemi kompjuterik nëpërmjet futjes së të dhënave, transmetimit, dëmtimit, fshirjes, shtrembërimit, ndryshimit apo shuarjes të të dhënave kompjuterike.

Neni 6

Keqpërdorimi i pajisjeve

1. Çdo Palë do të adaptojë legjislacionin të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë:

a) prodhimin, shitjen, prokurimin për përdorim, importim, shpërndarje ose, përndryshe vënie në disponim të:

(i) një pajisjeje, që përmban në program kompjuterik, i projektuar apo i adaptuar kryesisht për qëllimin e kryerjes së njëres prej veprave penale të parashikuara, në përputhje me nenin 2 deri në 5;

(ii) një fjalëkalim kompjuterik, kod hyrjeje apo të dhëna të ngjashme, nëpërmjet të cilave mundësohet hyrja në tërësinë apo në ndonjë pjesë të një sistemi kompjuterik, me qëllimin që ai të përdoret për arsyen e kryerjes së një prej krimeve të përcaktuara në nenet 2 deri në 5; dhe

b) zotërimin e një pajisjeje të referuar në paragrafët (a) (1) ose (2) të mësipërm, me qëllimin që ai të përdoret për arsyen e kryerjes së një prej veprave penale të përcaktuara në nenet 2 deri në 5, një Palë mund të kërkojë me ligj që një numër i këtyre mjeteve të zotërohet përpara se të lindë përgjegjësia penale.

2. Ky nen nuk duhet të interpretohet si ngarkesë e përgjegjësisë penale kur prodhimi, shitja, prokurimi për përdorim, importimi, shpërndarja apo, përndryshe, vënia në disponim ose zotërimi që referohet në paragrafin 1 të këtij neni nuk bëhet për qëllimet e kryerjes së një vepre penale, të përcaktuara në përputhje me nenet 2-5 të kësaj Konvente, sikurse dhe për testimin e autorizuar apo mbrojtjen e një sistemi kompjuterik.

3. Çdo Palë mund të rezervojë të drejtën të mos aplikojë paragrafin 1 të kësaj Konvente, me kusht që rezervimi të mos përfshijë shitjen, shpërndarjen ose, përndryshe, vënien në disponim të çështjeve të referuara në paragrafin 1 (a) (ii).

TITULLI 2

KRIMET E LIDHURA ME KOMPJUTERAT

Neni 7

Falsifikimet e lidhura me kompjuterat

Çdo Palë do të adaptojë legjislacionin të tillë dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë, futja e të dhënave, ndryshimi, fshirja, apo heqja e të dhënave kompjuterike që rezultojnë në të dhëna

joautentike, me qëllim që ato të konsiderohen apo të veprohet mbi to për qëllime ligjore sikurse ato të ishin autentike, pavarësisht nëse të dhënat janë të lexueshme apo të kuptueshme direkt. Një Palë mund të kërkojë synimin për të mashtruar ose një synim të ngjashëm të pandershëm përpara lindjes së përgjegjësisë penale.

Neni 8

Mashtrimet e lidhura me kompjuterat

Çdo Palë do të adaptojë legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë, shkaktimin e humbjes së pasurisë të një tjetri nëpërmjet:

- a) futjes së ndonjë të dhëne, ndryshimin, fshirjen apo heqjen e të dhënave kompjuterike;
- b) ndonjë interferencë me funksionimin e një sistemi kompjuterik, me synimin e pa ndershëm e mashtrues për prokurimin pa të drejtë të një përfitimi ekonomik për vete apo për një tjetër.

TITULLI 3

VEPRAT PENALE TË LIDHURA ME PËRMBAJTJEN

Neni 9

Veprat penale të lidhura me pornografinë e fëmijëve

Çdo Palë do të adaptojë legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë, në drejtimet e mëposhtme:

- a) prodhimin e pornografisë me fëmijë, me qëllimin e shpërndarjes së tij nëpërmjet një sistemi kompjuterik;
- b) ofrimi apo vënia në disponim e pornografisë për fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik;
- c) shpërndarja apo transmetimi i pornografisë për fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik;
- d) prokurimi i pornografisë për fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik për vete apo për një tjetër
- e) zotërimi i pornografisë për fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik apo në një mjet të memorizimit të të dhënave kompjuterike.

2. Për qëllimin e paragrafit 1 të mësipërm “pornografi me fëmijë” do të përfshijë material pornografik që dallon nga ana pamore:

- a) një minoren, i cili angazhohet në drejtime të qarta seksuale;
- b) një person, i cili duket që është minoren, i angazhuar në drejtime të qarta seksuale;
- c) imazhe realiste që prezantojnë një minoren të angazhuar në drejtime të qarta seksuale.

3. Për qëllimin e paragrafit 2 të mësipërm, termi “minoren” do të përfshijë të gjithë personat nën moshën 18 vjeç. Një Palë mundet, megjithatë, të kërkojë një limit moshe më të vogël, e cila nuk duhet të jetë më pak se 16 vjeç.

4. Çdo Palë mund të rezervojë të drejtën të mos aplikojë në tërësi apo pjesërisht paragrafin 1(d) dhe 1(e) dhe 2 d dhe 2 (c).

TITULLI 4

VEPRAT PENALE TË LIDHURA ME DHUNIMIN E TË DREJTËS SË AUTORIT DHE TË DREJTAVE TË TJERA TË LIDHURA ME TË

Neni 10

Veprat penale të lidhura me dhunimin e të drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të

1. Çdo Palë do të adaptojë legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, dhunimin e të drejtës së autorit, sikurse është përcaktuar në ligjet e asaj Pale në pajtim me detyrimet që ajo ka marrë sipas Aktit të Parisit të 24 korrikut 1971 të Konventës së Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike, Marrëveshjen në

Aspektet e Lidhura me Tregtimin e të Drejtave të Pasurisë Intelektuale dhe të Traktatit WIPO të të drejtave të autorit, me përjashtim të të drejtave morale të këshilluara nga kjo Konventë, ku akte të tilla janë kryer me dëshirë në shkallë komerciale dhe nëpërmjet një sistemi kompjuterik.

2. Çdo Palë do të adaptojë legjislacionin të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm dhunimin e të drejtave përkatëse, sikurse janë përcaktuar sipas ligjit të asaj Pale, në pajtim me detyrimet që kanë ndërmarrë nën Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Ekzekutuesve, Prodhuesve të Fonogrameve dhe Organizatave të Transmetimit, bërë në Romë (Konventa e Romës), Marrëveshjes në Aspektet e Lidhura me Tregtimin e të drejtave të Pasurive të Intelektualeve dhe të Ekzekutimeve WIPO dhe Traktateve të Fonogrameve, me përjashtim të ndonjë të drejte morale të këshilluar nga konventa të tilla, ku akte të tilla janë kryer me dëshirë në shkallë komerciale dhe nëpërmjet sistemeve kompjuterike.

3. Një Palë mund të rezervojë të drejtën për të mos imponuar përgjegjësi penale sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni në rrethana të kufizuara, me kushtin që zhdëmtime të tjera efektive të vihen në dispozicion dhe nuk shmangin Palën(ët) nga detyrimet ndërkombëtare të parashikuara në instrumentet ndërkombëtare që përmenden në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni.

Titulli 5

Sanskionet dhe përgjegjësitë e ndërvarura

Neni 11

Përpjekjet dhe ndihmat apo përkrahjet

1. Çdo Palë do të adaptojë legjislacionin të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim, për të ndihmuar apo kryet me qëllim, për të ndihmuar apo kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenin 2 deri në 10 të Konventës aktuale, me qëllimin që kjo vepër penale të kryhet.

2. Çdo Palë do të adaptojë legjislacionin të tillë dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim, një përpjekje për të kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenet 5, 7, 8, 9 (1)a dhe 9(1)c të kësaj Konvente.

3. Çdo Shtet mund të rezervojë të drejtën të mos aplikojë në tërësi apo pjesërisht paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 12

Përgjegjësia e përbashkët

1. Çdo Palë adapton legjislacionin të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme që të sigurohet që një person juridik të bëhet i përgjegjshëm për një vepër penale të parashikuar në përputhje me këtë Konventë, e kryer për përfitime nga çdo person fizik, i cili vepron individualisht ose pjesë e një organi të personit juridik, i cili ka një pozitë udhëheqëse mbi personin juridik, bazuar në:

- a) një fuqi të përfaqësimit të personit juridik;
- b) një autoritet për të marrë vendime në emër të një personi juridik;
- c) një autoritet për të ushtruar kontroll mbi personin juridik.

2. Përveç rasteve që tashmë janë dhënë në paragrafin 1, çdo Palë do të marrë masat e nevojshme që të sigurohet që një person juridik të jetë përgjegjës ku mungesa e supervizionit apo e kontrollit nga një person fizik përmendur në paragrafin 1 ka bërë të mundur kryerjen e një vepre penale të parashikuar në përputhje me këtë Konventë, për përfitimet e atij personi juridik nëpërmjet atij personi fizik, që ka vepruar nën autoritetin e tij.

3. Në pajtim me parimet ligjore të Palës, përgjegjësia e një personi juridik mund të jetë penale, civile apo administrative.

4. Një përgjegjësi e këtillë do të jetë pa ndonjë paragjykim ndaj përgjegjësive penale ndaj personave fizikë të cilët kanë kryer veprën.

Neni 13
Sanksionet dhe masat

1. Çdo Palë duhet të adaptojë legjislacionin të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme që të sigurohet që veprat penale, të parashikuara në përputhje me nenet 2-11, janë të dënueshme me sanksione efektive proporcionale dhe frenuese, të cilat përfshijnë edhe heqjen e lirisë.

2. Çdo Palë duhet të sigurohet që personat juridikë të mbajtur përgjegjës në përputhje me nenin 12 t'i nënshtrohen sanksioneve apo masave penale dhe jo penale, efektive, proporcionale dhe frenuese, duke përfshirë sanksionet monetare.

SEKSIONI 2
LIGJI PROCEDURAL

TITULLI 1
DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Neni 14
Sfera e zbatimit të dispozitave procedurale

1. Çdo Palë duhet të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera të nevojshme që të vendosen kompetencat dhe procedurat e caktuara në këtë seksion për shkak të hetimeve apo gjykimeve specifike penale.

2. Përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 21, çdo Palë aplikon kompetencat dhe procedurat e referuara në paragrafin 1 në:

- a) veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenet 2-11 të kësaj Konvente;
- b) vepra të tjera penale të kryera nëpërmjet një sistemi kompjuterik; dhe
- c) mbledhje e fakteve në formë elektronike të një veprë penale.

3.a. Çdo Palë mund të rezervojë të drejtën të aplikojë masat e referuara në nenin 20 vetëm për veprat penale apo kategoritë e veprave penale, të specifikuara në rezervë, me kusht që fusha e këtyre veprave penale apo kategorive të veprave penale, nuk është më tepër e kufizuar sesa fusha e veprave penale, mbi të cilat aplikohen masat e referuara në nenin 21. Mbi çdo Palë do të konsiderojë kufizimin e një rezervimi të tillë që të mundësojë aplikim sa më të gjerë të masave të referuara në nenin 20.

b) Kur një Palë, në sajë të kufizimeve në legjislacionin të saj në fuqi në kohën e adaptimit të kësaj Konvete, nuk ka mundësi të aplikojë masat e referuara në nenet 20 dhe 21 mbi komunikimet e transmetuara brenda një sistemi kompjuterik apo një dhënës shërbimesh, sistemi i të cilit:

(i) është operuar në të mirë të një grupi të mbyllur përdoruesish; dhe

(ii) nuk fut në punë rrjete publike komunikimesh dhe nuk është i lidhur me një sistem tjetër kompjuterik, publik apo privat, kjo Palë mund të rezervojë të drejtën të mos aplikojë këto masa për komunikime të tilla. Çdo Palë do të konsiderojë kufizimin e rezervimeve të tilla që të mundësojë aplikim sa më të gjerë të masave të referuara në nenet 20 dhe 21.

Neni 15
Kushtet dhe garancitë

1. Çdo Palë siguron që themelimi, zbatimi dhe aplikimi i kompetencave dhe procedurave të dhëna në këtë seksion u nënshtrohen kushteve dhe garancive të parashikuara në ligjin e brendshëm, të cilat u japin mbrojtjen e përshtatshme të të drejtave dhe lirive të njeriut, duke përfshirë të drejtat që rrjedhin nga detyrimet që ajo ka ndërmarrë në Konventën e Këshillit të Europës të vitit 1950 mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, Marrëveshjen Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara të Vitit 1966 mbi të Drejtat Politike dhe Civile dhe instrumente të tjerë ndërkombëtarë të aplikueshëm mbi të drejtat e njeriut, të cilat do të përfshijnë parimet e proporcionalitetit.

2. Kushte dhe garanci të tilla, në varësi të natyrës së kompetencave dhe procedurave përkatëse, ndër të tjera përfshijnë mbikëqyrjen gjyqësore ose mbikëqyrje tjetër të pavarur, arsyet që justifikojnë zbatimin dhe kufizimin në shtrirjen dhe kohëzgjatjen e kompetencave apo procedurave.

3. Deri në masën që është në përputhje me interesin publik, në veçanti me një administrim të drejtë apo të shëndetshëm të drejtësisë, një Palë do të konsiderojë efektin e kompetencave dhe procedurave në këtë seksion mbi të drejtat, përgjegjësitë dhe interesat legjitime të Palëve të treta.

TITULLI 2

RUAJTJA E PËRSHPEJTUAR E TË DHËNAVE KOMPJUTERIKE TË MEMORIZUARA

Neni 16

Ruajtja e përshpejtuar e të dhënave kompjuterike të memorizuara

1. Çdo Palë do të adaptojë legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme t'u mundësojë autoriteteve e saj kompetente të urdhërojnë apo të përftojnë ruajtjen e menjëhershme të të dhënave specifike kompjuterike, duke përfshirë të dhënat e trafikut, që kanë qenë të memorizuara nëpërmjet një sistemi kompjuterik në veçanti, ku ka baza për të besuar që të dhënat kompjuterike janë të zbuluara ndaj humbjeve apo modifikimeve.

2. Kur një Palë i jep efekt paragrafit 1 të mësipërm nëpërmjet një urdhri ndaj një personi që të ruajë të dhënat kompjuterike specifike të memorizuara në zotërimin apo kontrollin e një personi(ave), Pala duhet të adaptojë legjislacion të tillë dhe masa të tjera meqenëse duhet të jenë të nevojshme të detyrojnë atë person që të sigurojë dhe të mirëmbajë integritetin e të dhënave kompjuterike për një periudhë kohe aq të gjatë sa të jetë e nevojshme deri në një maksimum prej 90-ditësh që të mundësojë autoritetet kompetente të kërkojnë hapjen e tyre. Një Palë mund të sigurojë që një urdhër i tillë të rinovohet herë pas here.

3. Çdo Palë do të adaptojë legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të detyrojnë mbikëqyrësin apo persona të tjerë të cilët do të ruajnë të dhënat kompjuterike që të mbajnë në mënyrë konfidenciale ndërmarrjen e këtyre procedurave për një periudhë kohe të parashikuar nga ligji i brendshëm.

4. Kompetencat dhe procedurat e referuara në këtë nen u nënshtrohen neneve 14 dhe 15.

Neni 17

Ruajtja e përshpejtuar dhe hapja e pjesshme e të dhënave të trafikut

1. Çdo Palë do të adaptojë, në respektim të të dhënave të trafikut që duhet të ruhen sipas nenit 16, legjislacion të tillë dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për:

a) të siguar që ruajtja e përshpejtuar e të dhënave të trafikut të jetë e vlefshme, pavarësisht nëse një apo më tepër dhënë shërbimesh kanë qenë të përfshirë në transmetimin e atij komunikimi; dhe

b) të siguar që hapja e përshpejtuar e autoritetit kompetent të Palës(ave) apo të një personi të caktuar nga ai autoritet, të një sasi të mjaftueshme të të dhënave të trafikut, në mënyrë që të mundësojë Palën të identifikojë dhënësit e shërbimit dhe shtegun, nëpërmjet të cilit komunikimi u transmetua.

3. Kompetencat dhe procedurat e parashikuara në këtë nen u nënshtrohen neneve 14 dhe 15.

TITULLI 3

POROSIA E PRODHIMIT

Neni 18

Porosia e prodhimit

1. Çdo Palë do të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera të nevojshme që t'u japë targer autoriteteve kompetente të porosisin:

a) një person në territorin e tij të dorëzojë të dhëna kompjuterike të specifikuar në zotërim apo kontroll të personit(ave), të cilët janë memorizuar në një sistem kompjuterik apo në një mjet memorizimi të të dhënave kompjuterike; dhe

b) një dhënës shërbimi, i cili ofron shërbimet e tij në territorin e Palës që të dorëzojë informacion për abonentët, të lidhur me shërbime të tilla në zotërim apo kontrollin e këtij (këtyre) dhënësi(ave) shërbimesh.

2. Kompetencat dhe procedurat e përmendura në këtë nen u nënshtrohen neneve 14 dhe 15.

3. Për qëllimet e këtij neni “informacion abonenti” do të thotë çfarëdo informacion i futur në formën e të dhënave kompjuterike apo çfarëdo forme tjetër, që mbahen nga dhënësi i shërbimit, që kanë të bëjnë me abonuesit e shërbimeve të tij, të ndryshme nga të dhënat e trafikut ose të përmbajtjes, nëpërmjet të cilave ai mund të tregojë:

a) tipin e shërbimit të komunikimit të përdorur, kushtet teknike dhe periudhën e shërbimit;

b) identitetin e abonentit(ave), adresën gjeografike apo postare, numrin e telefonit apo numrat e tjerë hyrës, informacion mbi faturat dhe pagesën, të siguruar në bazë të marrëveshjes apo të marrëveshjeve të shërbimit;

c) çdo informacion tjetër në ambientin e instalimit të pajisjeve të komunikimit, të disponueshme në bazat e marrëveshjes apo të marrëveshjeve të shërbimit.

TITULLI 4

KËRKIMI DHE NGRIRJA E TË DHËNAVE KOMPJUTERIKE TË MEMORIZUARA

Neni 19

Kërkimi dhe ngrirja e të dhënave kompjuterike të memorizuara

1. Çdo Palë do të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme që t’i japin fuqi autoriteteve të saj kompetente të kërkojë apo, në mënyrë të ngjashme, të hyjë në:

a) një sistem kompjuterik apo një pjesë të tij dhe në të dhëna kompjuterike të memorizuara aty; dhe

b) në një mjet memorizimi të të dhënave kompjuterike në të cilën të dhënat kompjuterike mund të memorizohen në territorin e tij.

2. Çdo Palë do të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të sigurojnë që kur autoritet e saj kërkojnë apo në mënyrë të ngjashme hyjnë në një sistem kompjuterik specifik apo një pjesë të tij, sipas paragrafit 1(a), dhe kanë baza për të besuar që të dhënat e kërkuara janë memorizuar në një sistem kompjuterik apo në një pjesë së tij në territorin e saj, dhe të dhënat e tilla janë në mënyrë të ligjshme të kapshme prej ose janë të disponueshme në sistemin fillestar, autoritetet e këtyra duhet të jenë të afta që të shtrijnë në mënyrë të përsheptuar, kërkimet ose të hyjnë të jenë të afta që të shtrijnë në mënyrë të përsheptuar kërkimet ose të hyjnë në mënyrë të ngjashme në sistemet e tjera.

3. Çdo Palë do të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme t’i japin fuqi autoriteteve kompetente të saj të kapin apo, në mënyrë të ngjashme, të sigurojnë të dhëna kompjuterike të marra në përputhje me paragrafin 1 ose 2. Këto masa do të përfshijnë kompetencën:

a) të ngrijë ose në mënyrë të ngjashme të sigurojnë një sistem kompjuterik apo një pjesë të tij ose një mjet memorizimi të dhënash;

b) të bëjnë dhe të mbajnë një kopje të këtyre të dhënave kompjuterike;

c) të mirëmbajnë integritetin e të dhënave përkatëse të memorizuara; dhe

d) t’i bëjë të pahyshme apo t’i heqë këto të dhëna kompjuterike nga sistemet kompjuterike në të cilat ka akses.

4. Çdo Palë do të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme t’i japin fuqi autoriteteve kompetente që të urdhërojnë çdo person i cili ka njohuri rreth funksionimit të sistemeve kompjuterike apo masave të aplikuara për mbrojtjen e të dhënave kompjuterike në të, që të sigurojnë, sikurse është e arsyeshme, informacionin e nevojshëm, për të mundësuar ndërmarrjen e masave të parashikuara në paragrafin 1 dhe 2.

5. Kompetencat dhe procedurat e përmendura në këtë nen do t’i nënshtrohen neneve 14 dhe 15.

TITULLI 5
MBLEDHJA E TË DHËNAVE KOMPJUTERIKE NË KOHËN REALE

Neni 20

Mbledhja e të dhënave kompjuterike në kohën reale

1. Çdo Palë do të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme t'i japin fuqi autoriteteve kompetente:

a) të mbledhë apo të regjistrojë nëpërmjet aplikimit të mjeteve teknike në territorin e asaj Pale; dhe

b) të detyrojë një dhënë shërbimesh, brenda aftësive të saj ekzistuese teknike:

(i) që të mbledhë apo të regjistrojë, nëpërmjet aplikimit të mjeteve teknike në territorin e asaj Pale; ose

(ii) që të bashkëpunojë dhe të ndihmojë autoritetet kompetente në mbledhjen ose regjistrimin e të dhënave të trafikut, në kohë reale, të shoqëruara me komunikimet e specifikuar në territorin e saj, të transmetuara nëpërmjet një sistemi kompjuterik.

2. Kur një Palë, në sajë të parimeve të përcaktuara në sistemin ligjor të brendshëm, nuk mund të adaptojë masat e përmendura në paragrafin 1(a), ajo mundet, në vend të kësaj, të adaptojë legjislacion dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të siguruar mbledhjen apo regjistrimin në kohë reale të të dhënave të trafikut, të shoqëruara me komunikime të specifikuar në territorin e saj nëpërmjet aplikimit të mjeteve teknike.

3. Çdo Palë do të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme të detyrojnë një dhënë shërbimi që ta mbajë konfidencial faktin e çdo informacioni rreth ekzekutimit të çdo kompetence dhënë nga ky nen.

4. Kompetencat dhe procedurat e përmendura në këtë nen do t'i nënshtrohen neneve 14 dhe 15.

Neni 21

Interceptimi i të dhënave të përmbajtjes

Çdo Palë do të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme në lidhje me një fushë të veprave penale serioze, që do të përcaktohen nga ligji i brendshëm, që t'u japë fuqi autoriteteve të saj kompetente:

a) që të mbledhë apo të regjistrojë, nëpërmjet aplikimit të mjeteve teknike në territorin e asaj Pale; dhe

b) që të detyrojë një dhënë shërbimesh, brenda aftësive të saj ekzistuese teknike:

(i) që të mbledhë apo të regjistrojë nëpërmjet aplikimit të mjeteve teknike në territorin e asaj Pale; ose

(ii) që të bashkëpunojë dhe të ndihmojë autoritetet kompetente në mbledhjen dhe regjistrimin të dhënave të përmbajtjes, në kohë reale, të shoqëruara me komunikimet e specifikuar në territorin e saj të transmetuara nëpërmjet një sistemi kompjuterik.

2. Kur një Palë, në sajë të parimeve të përcaktuara në sistemin ligjor të brendshëm, nuk mund të adaptojë masat e referuara në paragrafin 1(a), ajo mundet, në vend të saj, të adaptojë legjislacion dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të siguruar mbledhjen apo regjistrimin në kohë reale të të dhënave të përmbajtjes të shoqëruara me komunikime të specifikuar në territorin e saj nëpërmjet aplikimit të mjeteve teknike.

3. Çdo Palë do të adaptojë një legjislacion të tillë dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme të detyrojnë një dhënë shërbimi që ta mbajë konfidencial faktin e çdo informacioni rreth ekzekutimit të çdo fuqie të dhënë nga ky nen.

4. Kompetencat dhe procedurat e përmendura në këtë nen u nënshtrohen neneve 14 dhe 15.

SEKSIONI 3
JURIDIKSIONI

Neni 22
Juridiksioni

1. Secila Palë merr masa të tilla legislative ose të tjera, që janë të nevojshme për të caktuar juridiksionin për çdo veprë penale të kryer në pajtim me nenet 2 –11 të kësaj Konvente, kur një veprë e tillë kryhet:

- a) në territorin e tij; ose
- b) në bordin e një anijeje që mban flamurin e asaj Pale; ose
- c) në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjit të kësaj Pale; ose
- d) nga njeri prej shtetasve të saj, nëse vepra penale është e dënueshme sipas ligjit penal ku ajo është kryer ose nëse vepra është kryer jashtë juridiksionit territorial të çdo Shteti.

2. Secili Shtet mund të rezervojë të drejtën për të mos zbatuar ose për të zbatuar vetëm në raste të caktuara ose kushte të caktuara rregullat juridiksionale të parashikuara në paragrafët (1)b –(1)d të këtij neni ose të ndonjë pjese të tyre.

3. Secila Palë merr masa të tilla që janë të nevojshme për të caktuar juridiksionin mbi të gjitha veprat penale të përmendura në nenin 24, paragrafi (1) i kësaj Konvente, në rastet kur kryësi i prezumuar i veprës penale është prezent në territorin e saj dhe ajo nuk e ekstradon atë tek një Palë tjetër, kryesisht mbi bazën e shtetësisë së tij/saj pas kërkesës së bërë për ekstradim.

4. Kjo Konventë nuk përjashton asnjë juridiksion penal të ushtruar në pajtim me ligjin vendas.

5. Nëse më shumë se një Palë pretendon juridiksionin mbi një veprë që prezumohet e kryer në pajtim me këtë Konventë, Palët e interesuara, kur është e përshtatshme, bëjnë një konsultë për të përcaktuar juridiksionin më të përshtatshëm për të bërë ndjekjen penale.

KAPITULLI III
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

SEKSIONI 1
PARIME TË PËRGJITHSHME

TITULLI I
PARIME TË PËRGJITHSHME MBI BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR

Neni 23
Parime të përgjithshme mbi bashkëpunimin ndërkombëtar

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli dhe duke zbatuar instrumentet përkatëse ndërkombëtare mbi bashkëpunimin ndërkombëtar për çështjet penale, të masave për të cilat është rënë dakord mbi bazën e legjislacionit uniform ose reciprok dhe ligjeve vendase, në masën më të gjerë të mundur për qëllimin e hetimeve ose të gjykimeve në çështjet penale të lidhura me sistemet kompjuterike dhe të të dhënave ose për mbledhjen e provave në format elektronike të një veprë penale.

TITULLI 2
PARIMET NË LIDHJE ME EKSTRADIMIN

Neni 24
Ekstradimi

1.a) Ky nen zbatohet për ekstradimet ndërmjet Palëve për veprat penale, të përcaktuara në pajtim me nenet 2 – 11 të kësaj Konvente, me kusht që ato të jenë të dënueshme sipas ligjit të të dy Palëve të interesuara me heqje lirie për një periudhë maksimale prej të paktën një vit ose me një dënim më të rëndë.

b) Nëse duhet të jepet një dënim minimal më i ulët sipas një marrëveshjeje të rënë dakord në bazë të legjislacionit uniform ose reciprok ose të një marrëveshjeje ekstradimi, duke përfshirë edhe Konventën Europiane mbi Ekstradimin (ETS Nr.24), të zbatueshme ndërmjet dy ose më shumë

Palëve, duhet të zbatohet dënimi më i ulët i parashikuar në të tilla marrëveshje ose traktate.

2. Veprat penale të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni konsiderohen të përfshihen në veprat e ekstradueshme për çdo marrëveshje ekstradimi që ekziston ndërmjet dy ose më shumë Palëve. Palët marrin përsipër t'i përfshijnë këto vepra në veprat penale të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që do të lidhet ndërmjet dy ose më shumë Palëve.

3. Kur një Palë, e cila e kushtëzon ekstradimin me eksiztencën e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për ekstradim nga një Palë tjetër që nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje ekstradimi, ajo mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradimin, në lidhje me çdo vepër e cila përmendet në paragrafin 1 të këtij neni si vepra të ekstradueshme ndërmjet tyre.

4. Palët, të cilët nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje, i njohin veprat penale, të cilat përmenden në paragrafin 1 të këtij neni si vepra të ekstradueshme ndërmjet tyre.

5. Ekstradimi u nënshtrohet kushteve të parashikuara nga ligji i Palës pritëse ose nga marrëveshjet e zbatueshme të ekstradimit, duke përfshirë edhe arsyet mbi të ciat Pala pritëse mund të refuzojë ekstradimin.

6. Nëse ekstradimi për një vepër penale që përmendet në paragrafin 1 të këtij neni refuzohet vetëm për shkak të shtetësisë së personit të kërkuar ose sepse Pala pritëse mendon se ka juridiksion mbi veprën penale, Pala pritëse, me kërkesë të Palës kërkuuese, ia paraqet çështjen organeve të veta kompetente për ndjekje penale dhe i njofton rezultatin përfundimtar Palës kërkuuese në kohën e duhur. Këto autoritete e marrin vendimin e tyre dhe i kryejnë hetimet dhe gjykimet e tyre në të njëjtën mënyrë ashtu si edhe në rastin e ndonjë veprë tjetër penale të një natyre të ngjashme sipas ligjit të kësaj Pale.

7.a) Në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit, secila Palë i njofton Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës emrin dhe adresat e çdo organi kompetent për bërjen ose marrjen e kërkesës për ekstradim ose arrest provizor në mungesën e një marrëveshjeje.

b) Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës krijon dhe rifreskon vazhdimisht një regjistër të organeve të caktuara për këtë qëllim nga Palët. Secila Palë siguron që detajet e mbajtura në regjistër të jenë gjithmonë të sakta.

TITULLI 3

PARIME TË PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME NDIHMËN E NDËRSJELLË

Neni 25

Parime të përgjithshme në lidhje me ndihmën e ndërsjellë

1. Palët i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë deri në masën më të gjerë të mundur për qëllimet e hetimeve ose gjykimeve të veprave penale që kanë të bëjnë me sistemet dhe të dhënat kompjuterike ose për mbledhjen e provave në formë elektronike për një vepër penale.

2. Secila Palë merr masa legjislative ose të tjera të tilla, që mund të jenë të nevojshme, për të përmbushur detyrimet e parashikuara në nenet 27-35.

3. Secila Palë, në kushte urgjente, mund të bëjë kërkesë për ndihmë të ndërsjellë ose korrespondencën e duhur për këtë, duke përdorur mjetet e shpejta të komunikimit, duke përfshirë faksin ose e-mailin, deri në atë masë që këto mjete të ofrojnë nivelet e duhura të sigurisë dhe autenticitetit (duke përfshirë përdorimin e kodimit, kur është e nevojshme), me një konfirmim pasues kur kërkohet nga Pala pritëse. Pala pritëse pranon dhe i përgjigjet kërkesës me njërën nga këto mjete të shpejta të komunikimit.

4. Përveç kur është parashikuar shprehimisht në nenet e këtij kapitulli, ndihma e ndërsjellë u nënshtrohet kushteve të parashikuara nga ligji i Palës pritëse ose nga marrëveshjet e zbatueshme për ndihmën e ndërsjellë, duke përfshirë edhe arsyet për të cilat Pala mund të refuzojë bashkëpunimin. Pala pritëse nuk e ushtron të drejtën për të refuzuar ndihmën e ndërsjellë në lidhje me veprat penale të përmendura në nenet 2 deri në 11, kryesisht për arsyen se kërkesa ka të bëjë me një vepër të cilën ai e konsideron si vepër penale fiskale.

5. Në përputhje me dispozitat e këtij kapitulli, kur Palës pritëse i lejohet ta kushtëzojë dhënien e ndihmës së ndërsjellë me ekzistencën e kriminalitetit të dyfishtë, ky kusht konsiderohet si i përmbushur nëse sjellja që është në themel të veprës penale për të cilën kërkohet edhe ndihma e ndërsjellë është një vepër penale për të cilën kërkohet edhe ndihma e ndërsjellë është një vepër penale

sipas ligjeve të kësaj Pale, pavarësisht nëse ligjet e saj e fusin veprën penale në të njëjtën kategori të veprave penale ose e emërtojnë këtë vepër penale me të njëjtën terminologji si edhe Pala kërkuuese.

Neni 26

Informacioni spontan

1. Brenda kufijve të ligjit të brendshëm dhe pa kërkesë paraprake, një Palë mund t'i ofrojë një Pale tjetër informacion, i cili është marrë në kuadrin e hetimeve të veta kur kjo e konsideron se dhënia e një informacioni të tillë mund ta ndihmojë Palën marrëse në fillimin ose kryerjen e hetimeve ose gjykrimeve në lidhje me veprat penale të përcaktuara në këtë Konventë ose mund të çojë në bërjen e një kërkesë për bashkëpunim nga kjo Palë sipas këtij kapitulli.

2. Para dhënies së një informacioni të tillë, Pala ofruese mund të kërkojë që ky të mbahet konfidencial dhe të përdoret me kusht. Nëse Pala marrëse nuk mund ta përmbushë këtë kërkesë, kjo njofton Palën ofruese, e cila pastaj vendos nëse informacioni duhet të jepet. Kur Pala marrëse e pranon informacionin me kushte, ajo mbetet e detyruar prej tyre.

TITULLI 4

PROCEDURAT QË KANË TË BËJNË ME KËRKESAT PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE, NË MUNGESË TË MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE TË ZBATUESHME

Neni 27

Procedurat që kanë të bëjnë me kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike, në mungesë të marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme

1. Nëse nuk ka traktat ose marrëveshje në fuqi mbi bazën e legjislacionit uniform ose reciprok ndërmjet Palëve dërguese dhe pritëse, Palët e interesuara bien dakord të zbatojnë një pjesë ose të gjithë pjesën e mëposhtme të këtij neni.

2. a) Secila Palë cakton një ose disa organe qendrore, që do të jenë të përgjegjshëm për të dërguar ose përgjigjur kërkesave për ndihmë të ndërsjellë, përmbushjen e kërkesave të tilla ose transmetimin e tyre tek organet kompetente për plotësimin e tyre.

b) Organet qendrore komunikojnë direkt me njëri-tjetrin.

c) Në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit, secila Palë i njofton Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës emrin dhe adresat e organeve të caktuara sipas këtij paragrafi.

d) Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës krijon dhe rifreskon një regjistër me organet qendrore të caktuara për këtë qëllim nga Palët. Secila Palë siguron që të dhënat e shkruara në regjistër janë gjithmonë të sakta.

3. Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë që bëhen sipas këtij neni përmbushen në pajtim me procedurat e caktuara nga Pala kërkuuese, përveç kur ato janë të papajtueshme me ligjin e Palës pritëse.

4. Pala pritëse, përveç shkaqeve për refuzim të parashikuara sipas nenit 25 paragrafi (4), mund ta refuzojë dhënien e ndihmës kur:

a) kërkesa ka të bëjë me një vepër penale të cilën Pala pritëse e konsideron vepër penale politike ose vepër të lidhur me një vepër politike; ose

b) ai mendon se përmbushja e kërkesës mund të paragjykojë sovranitetin, siguron rendin publik ose interesa të tjera të saj.

5. Pala pritëse mund ta shtyjë procedimin për një kërkesë të tillë kur ky procedim do të cenonte hetimet ose gjykimet penale të kryera nga organet e veta.

6. Para refuzimit ose shtyrjes së dhënies së ndihmës, Pala pritëse, kur është e përshtatshme pas konsultimeve me Palën kërkuuese, shikon nëse kërkesa mund të përmbushet pjesërisht ose duke respektuar kushtet që ajo i mendon të nevojshme.

7. Pala pritëse njofton menjëherë Palën kërkuuese në lidhje me rezultatin e përmbushjes së një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë. Kur kërkesa refuzohet ose shtyhet, jepen arsyet e refuzimit ose shtyrjes. Pala pritëse informon, gjithashtu, Palën kërkuuese në lidhje me arsyet që e bëjnë të pamundur

përmbushjen e kërkesës që mund ta shtyjnë atë së tepërmi.

8. Pala kërkuese mund të kërkojë që Pala pritëse të mbajë konfidencial faktin dhe përmbajtjen e kërkesës së bërë në pajtim me këtë kapitull, përveç deri në atë masë që është e nevojshme për përmbushje e kërkesës. Nëse Pala pritëse nuk mund të përmbushë kërkesën për ruajtjen e konfidencialitetit, ajo duhet të njoftojë menjëherë Palën kërkuese, e cila pastaj duhet të vendosë nëse kërkesa megjithëkëtë duhet të përmbushet.

9. (a) Në rast urgjence, kërkesat për ndihmë të ndërsjellë ose komunikimet në lidhje me këtë mund të dërgohen direkt nga organet gjyqësore të Palës kërkuese për këto organe të Palës pritëse. Për çdo rast të tillë, një kopje i dërgohet njëkohësisht organit qendror të Palës pritëse. Për çdo rast të tillë, një kopje i dërgohet njëkohësisht organit qendror të Palës pritëse nga organi qendror i Palës kërkuese.

b) Çdo kërkesë ose komunikim sipas këtij paragrafi mund të bëhet nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

c) Kur bëhet një kërkesë sipas nënparagrafit (a) dhe organi nuk është kompetent për t'u marrë me kërkesën, ai ia dërgon këtë kërkesë organit kombëtar kompetent dhe njofton drejtpërdrejt Palën kërkuese për këtë që ka bërë.

d) Kërkesat ose komunikimet e bëra sipas këtij paragrafi, të cilat nuk kanë të bëjnë me ndonjë masë shtrënguese, mund të dërgohen drejtpërdrejt nga organet kompetente të Palës dërguese tek organet kompetente të Palës pritëse.

e) Secila Palë, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit, mund të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës që, për arsye efience, kërkesat sipas këtij paragrafi të drejtohen tek organi i saj qendror.

Neni 28

Konfidencialiteti dhe kufizimi në përdorim

1. Nëse nuk ka ndonjë marrëveshje në lidhje me ndihmën e ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose reciprok në fuqi ndërmjet Palëve kërkuese dhe pritëse, zbatohen dispozitat e këtij neni. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen kur një traktat, marrëveshje ose legjislacion i tillë është në fuqi, përveç kur në vend të tyre Palët e interesuara bien dakort të zbatojnë një ose të gjithë pjesën tjetër të këtij neni.

2. Pala pritëse mund ta kushtëzojë dhënien e informacionit ose materialeve në përgjigje të kërkesës me:

a) mbajtjen konfidenciale kur kërkesa për ndihmë të ndërsjellë nuk do të mund të përmbushej pa një kusht të tillë; ose

b) mospërdorjen në hetime ose gjykime të tjera të ndryshme nga ato të përmendura në kërkesë.

3. Kur Pala dërguese nuk mund të përmbushë kushtin e përmendur në paragrafin 2, ajo njofton menjëherë Palën tjetër, e cila pastaj vendos nëse informacioni duhet të jepet. Kur Pala dërguese e pranon kushtin, ajo mbetet e detyruar prej tij.

4. Secila Palë që jep informacion ose materiale me kushtin e përmendur në paragrafin 2, mund t'i kërkojë Palës tjetër të shpjegojë, në lidhje me këtë kusht, përdorimin që do t'i bëjë informacionit ose materialit.

SEKSIONI 2

DISPOZITA TË VEÇANTA

TITULLI I

NDIHMA E NDËRSJELLË JURIDIKE NË LIDHJE ME MASAT PROVIZORE

Neni 29

Ruajtja e menjëhershme e të dhënave të ruajtura në kompjuter

1. Një Palë mund t'i kërkojë një Pale tjetër të urdhërojë ose të sigurojë në ndonjë mënyrë tjetër ruajtjen e përshpejtuar të të dhënave të regjistruara nëpërmjet një sistemi kompjuterik, i cili ndodhet brenda territorit të Palës tjetër dhe në lidhje me të cilën Pala dërguese ka ndërmend të bëjë një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë për të kërkuar hyrje të ngjashme, ngrirje, sigurim të ngjashëm ose hapje të të

dhënave.

2. Një kërkesë për ruajtjen e të dhënave e bërë sipas paragrafit 1 përcakton:

- a) organin që kërkon informacionin;
- b) veprën penale që është objekt i hetimit ose gjykimit penal dhe një përshkrim të shkurtër me faktet përkatëse;
- c) të dhënat kompjuterike të regjistruara që duhet të ruhen dhe lidhja me veprën penale;
- d) çdo informacion të mundshëm për të identifikuar mbajtësin e të dhënave të regjistruara në kompjuter ose vendndodhjen e sistemit kompjuterik;
- e) nevojën e ruajtjes; dhe
- f) që Pala ka ndër mend të bëjë një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike për kërkimin e hyrjes së ngjashme, ngrirjen, ose sigurimin në mënyrë tjetër, ose njoftimin e të dhënave kompjuterike të regjistruara.

3. Me marrjen e një kërkesë nga një Palë tjetër, Pala pritëse merr të gjitha masat e nevojshme për të ruajtur në mënyrë të përsheptuar të dhënat e përcaktuara në pajtim me ligjin vendas. Për qëllimet e përgjigjes së një kërkesë, kriminaliteti i dyfishtë nuk kërkohet si kusht për sigurimin e ruajtjes.

4. Një Palë që kërkon kriminalitet të dyfishtë, si një kusht për përgjigjen e një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë për kërkim ose hyrje, ngrirje ose sigurim në ndonjë mënyrë tjetër, ose hapjen e të dhënave, në lidhje me veprat penale të ndryshme nga ato të përcaktuara në pajtim me nenet 2 –11 të kësaj Konvente, mund të rezervojë të drejtën për të refuzuar kërkesën për ruajtjen sipas këtij neni, në rastet kur ajo ka arsye për të besuar se në momentin e njoftimit nuk mund të përmbushet kushti i kriminalitetit të dyfishtë.

5. Përveç kësaj, një kërkesë për ruajtje mund të refuzohet vetëm kur:

- a) kërkesa ka të bëjë me një vepër penale që Pala pritëse e konsideron vepër penale politike ose vepër të lidhur me një vepër politike; ose
- b) Pala pritëse gjykon se përmbushja e kërkesës ka të ngjarë të cenojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera thelbësore.

6. Kur Pala pritëse mendon se ruajtja nuk ka për të siguruar marrjen e mëvonshme të të dhënave ose kërcënon konfidencialitetin ose cenon në ndonjë mënyrë tjetër hetimin e Palës dërguese, ajo e njofton këtë menjëherë, e cila pastaj vendos nëse, megjithëkëtë, kërkesa duhet të përmbushet.

7. Çdo ruajtje e bërë në pajtim me kërkesën e përmendur në paragrafin 1 është për një periudhë jo më të vogël se 60 ditë në mënyrë që t'i jepet mundësi Palës dërguese për të bërë një kërkesë për kërkimin, hyrjen, ngrirjen, ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër, ose njoftimin e të dhënave. Pas marrjes së një kërkesë të tillë, të dhënat vazhdojnë të ruhen në pritje të një vendimi për këtë kërkesë.

Neni 30

Njoftimi i përsheptuar i të dhënave të ruajtura mbi komunikimin

1. Kur gjatë përmbushjes së një kërkesë të bërë sipas nenit 29 për ruajtjen e të dhënave të dërgimit të një komunikate të veçantë, Pala pritëse zbulon se një ofrues shërbimesh në një Shtet tjetër ka qenë i implikuar në dërgimin e komunikatës, Pala pritëse i njofton menjëherë Palës dërguese një masë të mjaftueshme të dhënash për të identifikuar dhënësin e shërbimeve dhe shtegun nëpërmjet së cilit komunikata është transmetuar.

2. Njoftimi i të dhënave sipas paragrafit 1 mund të mos jepet vetëm kur:

- a) kërkesa ka të bëjë me një vepër penale, të cilën Pala pritëse e konsideron si vepër penale politike ose vepër që lidhet me një vepër penale politike; ose
- b) Pala pritëse është e mendimit se përmbushja e kërkesës mund të cenojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera thelbësore.

TITULLI 2

NDIHMA E NDËRSJELLË NË LIDHJE ME KOMPETENCËN E HETIMIT

Neni 31

Ndihma e ndërsjellë në lidhje me hyrjen në të dhënat kompjuterike të regjistruara

Njëra Palë mund t'i kërkojë Palës tjetër të kërkojë, hyjë, ngrijë ose sigurojë, në ndonjë mënyrë tjetër, dhe të njoftojë të dhënat e regjistruara nëpërmjet një sistemi kompjuterik që ndodhet brenda territorit të Palës pritëse, duke përfshirë të dhënat që janë ruajtur në pajtim me nenin 29.

2. Pala pritëse i përgjigjet kërkesës nëpërmjet zbatimit të instrumentave ndërkombëtare, marrëveshjeve dhe ligjeve të përmendura në nenin 23 dhe në pajtim me dispozitat e tjera përkatëse të këtij kapitulli.

Përgjigja e kërkesës duhet t'i jepet në mënyrë të përshpejtuar kur:

- a) ka arsye për të besuar se të dhënat përkatëse mund të humbin ose të modifikohen; ose
- b) instrumentet, marrëveshjet dhe ligjet e përmendura në paragrafin 2 parashikojnë bashkëpunimin e përshpejtuar.

Neni 32

Hyrja ndërkufitare në të dhënat e regjistruara në kompjuter me leje ose kur janë të hapura për publikun

Pa marrë autorizimin nga Pala tjetër, një Palë mund:

- a) të hyjë në të dhënat e regjistruara në kompjuter të hapura për publikun (burim i hapur), pavarësisht se ku ndodhen gjeografikisht të dhënat; ose
- b) të hyjë ose të marrë, nëpërmjet një sistemi kompjuterik në territorin e tij, të dhënat e regjistruara në kompjuter tek një Palë tjetër, nëse Pala merr lejen e ligjshme dhe të vullnetshme të personit që ka kompetencën ligjore t'i njoftojë të dhënat Palës nëpërmjet sistemit kompjuterik.

Neni 33

Ndihma e ndërsjellë në lidhje me marrjen brenda kohës reale të të dhënave

1. Palët i japin njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë në lidhje me marrjen brenda kohës reale të të dhënave që kanë të bëjnë me njoftimet e veçanta në territorin e tij që jepen nëpërmjet një sistemi kompjuterik. Në pajtim me paragrafin 2, ndihma e ndërsjellë trajtohet sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara sipas ligjit të brendshëm.

2. Secila Palë jep ndihmë të ndërsjellë të paktën në lidhje me veprat penale për të cilat marrja në kohën reale e të dhënave do të ishte e mundur në çështje të ngjashme të brendshme.

Neni 34

Ndihma e ndërsjellë në lidhje me interceptimin e të dhënave të përmbajtjes

Palët i japin njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë në lidhje me marrjen në kohën reale ose regjistrimin e të dhënave të përmbajtjes të mesazheve të specifikuar të transmetuara nëpërmjet sistemit kompjuterik deri në masën e lejuar nga traktatet e zbatueshme dhe ligjet vendase.

TITULLI 3 24/7 RRJETI

Neni 35 **24/7 Rrjeti**

1. Secila Palë cakton një pikë kontakti që të punojë 24 orë, me bazë 7 ditë në javë me qëllim që të sigurohet dhënia e ndihmës së menjëhershme për qëllimet e hetimeve ose gjyqimeve për veprat penale në lidhje me sistemet dhe të dhënat kompjuterike ose për marrjen e provave në formë elektronike për një vepër penale. Një ndihmesë e tillë përfshin lehtësimin, ose kur është e lejuar nga ligji dhe praktika vendase, duke bërë menjëherë:

- a) dhënien e ndihmës teknike;

- b) ruajtjen e të dhënave në pajtim me nenet 29 dhe 30; dhe
 - c) marrjen e provave, duke dhënë informacion ligjor dhe vendnodhjen e personave të dyshuar.
2. a) Pika e kontaktit të një Pale ka tagrin e bërjes së njoftimeve drejtuar pikës së kontaktit të një Pale tjetër mbi një bazë të përshpejtuar.
- b) Nëse pika e kontaktit e caktuar nga njëra Palë nuk është pjesë e organit ose organeve të Palës kompetente për dhënien e ndihmës së ndërsjellë ndërkombëtare ose për ekstradimin, pika e kontaktit duhet të sigurojë që ajo të jetë e aftë të koordinojë me organin ose organet përkatëse mbi një bazë të përshpejtuar.
- 3) Secila Palë siguron që të vërë në dispozicion personel të kualifikuar dhe të pajisur me qëllim që të lehtësojë bashkëpunimin e rrjetit.

KAPITULLI IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 36

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është e hapur për t'u nënshkruar nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës dhe nga Shtete joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj.
2. Kjo Konventë duhet të ratifikohet, pranohet ose aprovohet. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.
3. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tremujore pas datës në të cilën pesë Shtete, duke përfshirë të paktën tre Shtete Anëtare të Këshillit të Europës të kenë shprehur pëlqimin e tyre për të respektuar Konventën në pajtim me dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2.
4. Në lidhje me ndonjë Shtet nënshkrues, i cili e shpreh më vonë pëlqimin e tij për ta respektuar atë, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tremujore pas datës së shprehjes së pëlqimit të tij për të respektuar Konventën në pajtim me dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2.

Neni 37

Anëtarësimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimeve dhe marrjes së pëlqimit unanim të Shteteve Palë në Konventë, mund të ftojë çdo Shtet që nuk është anëtar i Këshillit që nuk ka marrë pjesë në hartimin e saj, të anëtarësohet në Konventë. Vendimi merret nga shumica e parashikuar në nenin 20 (d) të Statutit të Këshillit të Europës dhe me votën unanime të përfaqësuesve të Shteteve Palë që nuk kanë të drejtën e përfaqësimit në Komitetin e Ministrave.
2. Në lidhje me çdo Shtet që anëtarësohet në Konventë sipas paragrafit 1 të mësipërm, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të afatit tremujor pas datës së depozitimit të instrumentit të anëtarësimit tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 38

Zbatimi territorial

1. Çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo aprovimit ose anëtarësimit, mund të specifikojë territorin ose pjesët e territorit ku zbatohet kjo Konventë.
2. Çdo Palë në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund ta zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Në lidhje me një territor të tillë, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo territor të përcaktuar në një deklaratë të tillë, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të

Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tremujore pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 39

Efektet e Konventës

1. Qëllimi i kësaj Konvente është të plotësojë traktatet ose marrëveshjet ekzistuese shumëpalëshe ose dypalëshe ndërmjet Palëve, duke përfshirë dispozitat e:

- Konventës Europiane për Ekstradimin, të hapur për nënshkrim në Paris më 13 dhjetor 1957 (ETS Nr.24);

- Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale, të hapur për nënshkrim në Strasburg, më 20 prill 1959 (ETS nr.30);

- Protokolli Shtesë të Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale, të hapur për nënshkrim në Strasburg, më 17 mars 1978 (ETS Nr.99)

2. Nëse dy ose më shumë Palë kanë përfunduar një marrëveshje ose traktat për çështjet e trajtuara në këtë Konventë ose kanë specifikuar në ndonjë mënyrë tjetër marrëdhëniet e tyre për këto çështje, ose kur një gjë të tillë do ta bëjnë në të ardhmen, ata do të kenë të drejtën të zbatojnë këtë marrëveshje ose traktat, ose t'i rregullojnë këto marrëdhënie respektivisht. Megjithatë, kur Palët i kanë specifikuar marrëdhëniet e tyre në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë në një mënyrë të ndryshme nga parashikimet e bëra këtu, ata do ta bëjnë një gjë të tillë në një mënyrë që nuk bie në kundërshtim me objektivat dhe principet e Konventës.

4. Asgjë në këtë Konventë nuk cenon të drejta, kufizime, detyrime dhe përgjegjësi të tjera të një Pale.

Neni 40

Deklarimet

Nëpërmjet njoftimit me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, çdo Shtet në momentin e nënshkrimit, ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit, mund të deklarojë se i lejon vetes mundësinë e kërimit të elementëve shtesë sipas parashikimeve të nenit 2, nenit 3, nenit 6 paragrafi 1(b), nenit 7, nenit 9 paragrafi 3 dhe neni 27 paragrafi 9 (e).

Neni 41

Klauzola federale

1. Një Shtet federal mund të rezervojë të drejtën e marrjes së detyrimeve sipas Kapitullit II të kësaj Konvente, në pajtim me principet themelore që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet qeverisë qendrore dhe Shteteve përbërës ose njësive të ngjashme territoriale që ai është i aftë për të bashkëpunuar sipas kapitullit III.

2. Kur bën një rezervë sipas paragrafit 1, një Shtet federal mund të mos i zbatojë kushtet e një rezerve të tillë për të përjashtuar ose zvogëluar në një masë të madhe detyrimet e tij për të marrë masat e parashikuara në kapitullin II. Mbi të gjitha, ai duhet të marrë masa për një aftësi të gjerë dhe të efektshme të përmbartimit ligjor në lidhje me këto masa.

3. Në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i së cilës futet nën juridiksionin e Shteteve përbërës ose njësive të ngjashme territoriale, që nuk janë të detyruar nga sistemi kushtetues i federatës për të marrë masa legjislative, qeveria federale informon organet kompetente të këtyre Shteteve për këto dispozita, të shoqëruara me mendimin e saj pozitiv, duke i inkurajuar ata të marrin masat e duhura për t'i bërë ato të efektshme.

Neni 42

Rezervat

Nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit,

aprovimit ose anëtarësimit mund të deklarojë se i lejon vetes rezervën (at) e parashikuara në nenin 4 paragrafi 2, neni 6 paragrafi 3, neni 9 paragrafi 4, neni 10 paragrafi 3, neni 11 paragrafi 3, neni 14 paragrafi 3, neni 22 paragrafi 2, neni 29 paragrafi 4 dhe neni 41 paragrafi 1. Nuk mund të bëhet asnjë rezervë tjetër.

Neni 43

Statusi dhe tërheqja e rezervave

1. Një Palë që ka bërë një rezervë sipas nenit 42 mund ta tërheqë atë pjesërisht ose plotësisht nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Kjo tërheqje bëhet e efektshme në datën e marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm. Nëse njoftimi përcakton se tërheqja e rezervës bëhet në një datë që caktohet atje, dhe një datë e tillë është e mëvonshme sesa data e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, tërheqja bëhet e efektshme në këtë datë të mëvonshme.

2. Një Palë që ka bërë një rezervë të përmendur në nenin 42 e tërheq një rezervë të tillë, pjesërisht ose plotësisht, menjëherë sapo këtë ta lejojnë rrethanat.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës mund të konsultohet me Palët që kanë bërë një ose më shumë rezerve sipas parashikimeve të nenit 42 në lidhje me mundësinë e tërheqjes së kësaj (këtyre) rezervë (rezervave).

Neni 44

Ndryshimet

1. Ndryshimet e kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo Palë dhe i komunikohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës, Shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në përpilimin e kësaj Konvente, si edhe çdo Shteti që është anëtarësuar në të ose është ftuar të anëtarësohet në këtë Konventë në pajtim me dispozitat e nenit 37.

2. Çdo ndryshim, që propozohet nga një Palë, i komunikohet Komitetit Europian për Problemet e Krimit (CDPC), i cili i paraqet mendimin e vet mbi ndryshimin e propozuar Komitetit të Ministrave.

3. Komiteti i Ministrave konsideron ndryshimin e propozuar dhe mendimin e paraqitur Komitetit Europian mbi Problemet e Krimit (CDPC) dhe, pas konsultimeve me Shtetet joanëtare Palë në këtë Konventë, mund të adaptojnë ndryshimin.

4. Teksti i çdo ndryshimi, i adoptuar nga Komiteti i Ministrave në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, i paraqet Palëve për pranim.

5. Çdo ndryshim i adaptuar sipas paragrafit 3 të këtij neni hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pasi të gjitha Palët të kenë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e bërë prej tyre.

Neni 45

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Komiteti Europian për Problemet e Krimit (CDPC) mbahet i informuar në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Konvente.

2. Në rastin e një mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, ata kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nëpërmjet bisedimeve ose ndonjë mjet tjetër të zgjidhjes paqësore të zgjedljes së tyre, duke përfshirë paraqitjen e mosmarrëveshjes Komitetit Europian për Problemet e Krimit (CDPC), një gjykatë arbitrazhi vendimet e së cilës janë të detyrueshme për Palët ose Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sipas marrëveshjes së Palëve të interesuara.

Neni 46

Konsultimet e Palëve

1. Palët, sipas rastit, konsultohen periodikisht me qëllim që të lehtësojnë:

a) përdorimin e efektshëm dhe zbatimin e kësaj Konvente, duke përfshirë identifikimin e çdo problemi në lidhje me të, si edhe efektet e çdo deklarate ose rezerve të bërë sipas kësaj Konvente;

b) shkëmbimi i informacionit mbi zhvillimet e rëndësishme ligjore, politike ose teknologjike në lidhje me krimet në fushën elektronike dhe mbledhjen e provave në formë elektronike;

c) konsideratat në lidhje me plotësimet ose ndryshimet e mundshme të Konventës.

2. Komiteti European për Problemet e Krimit (CDPC) mbahet i informuar periodikisht në lidhje me rezultatin e konsultimeve të përmendura në paragrafin 1.

3. Komiteti European për Problemet e Krimit (CDPC), kur është e përshtatshme, lehtëson konsultimet e përmendura në paragrafin 1 dhe merr masat e nevojshme për të ndihmuar Palët në përpjekjet e tyre për të plotësuar ose ndryshuar Konventën. Në tre vitet e fundit pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti European për Problemet e Krimit (CDPC), në bashkëpunim me Palët, bën një rishikim të të gjitha dispozitave të Konventave dhe nëse është e nevojshme rekomandon ndryshimet e duhura.

4. Përveç kur merren përsipër nga Këshilli i Europës, shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i dispozitave të paragrafit 1 përballohen nga Palët në mënyrën e përcaktuar prej tyre.

5. Palët ndihmohen nga Sekretariati i Këshillit të Europës në kryerjen e funksioneve të tyre sipas këtij neni.

Neni 47

Denoncimi

1. Çdo Palë, në çdo moment, mund të denoncojë këtë Konventë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një denoncim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 48

Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, Shtet joanëtare të cilët kanë marrë pjesë në përpilimin e kësaj Konvente siu dhe çdo Shtet që është anëtarësuar ose është ftuar të anëtarësohet në këtë Konventë për:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, aprovimi ose anëtarësimi;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të Konventës në pajtim me nenet 36 dhe 37;

d) çdo deklaratë të bërë sipas neneve 40 dhe 41 ose rezervë të bërë në pajtim me nenin 42;

e) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me Konventën.

Si provë, të poshtëshënuarit kanë firmosur Konventën, duke qenë të autorizuar rregullisht.

Bërë në _____ më _____ 2001, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë njëllorj autentike, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u transmeton kopje të vërtetuara të gjithë Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës, Shteteve joanëtare, të cilat kanë marrë pjesë në përpilimin e kësaj Konvente dhe çdo Shteti të ftuar për t'u anëtarësuar.

L I G J

Nr. 8889, datë 25.4.2002

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7932, DATË 17.5.1995; NR.8286, DATË 16.2.1998; NR.8392, DATË 2.9.1998; NR.8575, DATË 3.2.2000; NR.8776, DATË 26.4.2001 DHE NR.8852, DATË 27.12.2001

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995; nr.8286, datë 16.2.1998; nr.8392, datë 2.9.1998; nr.8575, datë 3.2.2000; nr.8776, datë 26.4.2001 dhe nr.8852, datë 27.12.2001 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

- Në shkronjën "a" shifra "26" bëhet "23,5".
- Në shkronjën "b" shifra "10" bëhet "9,5".

Neni 2

Në pikën 1 të nenit 14 bëhen këto ndryshime:

- Në shkronjën "a" shifra "1,5" bëhet "0,8".
 - Në shkronjën "b" shifra "2,8" bëhet "2,3".
 - Në shkronjën "c" shifra "31,7" bëhet "29,9".
- Në shkronjën "b" të pikës 2 të nenit 14, shifra "6" bëhet "5".

Neni 3

Pas shkronjës "b" të nenit 30 shtohet shkronja "b/1" me këtë përmbajtje: "Pension pleqërie i reduktuar".

Neni 4

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë të pikës 1 shprehja "60 vjeç" bëhet "65 vjeç" dhe shprehja "55 vjeç" bëhet "60 vjeç".

Neni 5

Pas nenit 31 shtohet neni 31/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 31/1

Pension pleqërie i reduktuar

Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar kur:

- a) kanë plotësuar jo më pak se 35 vjet sigurim;
- b) kanë mbushur moshën 62 vjeç për burrat e 57 vjeç për gratë, kur mosha e daljes në pension të plotë pleqërie sipas nenit 92 është më e madhe se këto mosha;
- c) nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar.

Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar për gjithë kohën e përfitimit. Koeficienti i reduktimit përcaktohet me ligj.

Këshilli i Ministrave paraqet për miratim në Kuvend brenda datës 31.12.2002 tabelën e koeficientit të reduktimit të pensionit."

Neni 6

Në nenin 34, shprehja "kur të arrijë moshën 60 vjeç" zëvendësohet me shprehjen "kur të arrijë burri moshën 65 vjeç dhe gruaja moshën 60 vjeç".

Neni 7

Paragrafi i fundit i pikës 1 të nenit 90 ndryshohet si vijon:
"Nga 1.1.1996 deri më 1.7.2002 të punësuarit 10 % në vazhdim 9,5 %".

Neni 8

Neni 92 ndryshohet si vijon:

“Neni 92

Zgjatja graduale e moshës dhe periudhës së sigurimit për pension

Mosha dhe periudha e sigurimit për pension të plotë pleqërie, deri në arritjen e moshës dhe plotësimin e periudhës së sigurimit, që përcaktohen në pikën 1 të ligjit, rriten sipas tabelave që vijnë:

MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRKOHEN NË VITE PËR SECILËN KATEGORI BURRI

	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
Vitet	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	50	20	55	25	60	25
1994	50	20	55	25	60	25
1995	51	21	56	26	60	26
1996	51	21	56	27	60	27
1997	52	22	57	28	60	28
1998	52	22	57	29	60	29
1999	53	23	58	30	60	30
2000	53	23	58	31	60	31
2001	54	24	59	32	60	32
01.07.2002 - 30.06.2003	54	24	59	33	60v 6m	33
01.07.2003 - 30.06.2004	55	25	60	34	61v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	55	25	60v 6m	35	61v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	56	26	61v	35	62v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	56	27	61v 6m	35	62v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	57	28	62v	35	63v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	57	29	62v 6m	35	63v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	58	30	63v	35	64v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	58	31	63v 6m	35	64v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	59	32	64v	35	65v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	59	33	64v 6m	35		
01.07.2013 - 30.06.2014	60	34	65v	35		
01.07.2014 - 30.06.2015	60v 6m	35				
01.07.2015 - 30.06.2016	61v	35				

01.07.2016 - 30.06.2017	61v 6m	35
01.07.2017 - 30.06.2018	62v	35
01.07.2018 - 30.06.2019	62v 6m	35
01.07.2019 - 30.06.2020	63v	35
01.07.2020 - 30.06.2021	63v 6m	35
01.07.2021 - 30.06.2022	64v	35
01.07.2022 - 30.06.2023	64v 6m	35
2023 e në vazhdim	65v	35

**MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRKOHEN NË
VITE PËR SECILËN KATEGORI
GRUAJA**

	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
Vitet	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	45	15	50	20	55	20
1994	45	15	50	21	55	21
1995	46	16	51	22	55	22
1996	46	17	51	23	55	23
1997	47	18	52	24	55	24
1998	47	19	52	25	55	25
1999	48	20	53	26	55	26
2000	48	21	53	28	55	28
2001	49	22	54	30	55	30
01.07.2002 - 30.06.2003	49	23	54	32	55v 6m	32
01.07.2003 - 30.06.2004	50	24	55	34	56v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	50	25	55v 6m	35	56v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	51	26	56v	35	57v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	51	27	56v 6m	35	57v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	52	28	57v	35	58v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	52	29	57v 6m	35	58v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	53	30	58v	35	59v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	53	31	58v 6m	35	59v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	54	32	59v	35	60v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	54	33	59v 6m	35		
01.07.2013 - 30.06.2014	55	34	60v	35		
01.07.2014 - 30.06.2015	55v 6m	35				
01.07.2015 - 30.06.2016	56v	35				
01.07.2016 - 30.06.2017	56v 6m	35				
01.07.2017 - 30.06.2018	57v	35				
01.07.2018 - 30.06.2019	57v 6m	35				
01.07.2019 - 30.06.2020	58v	35				
01.07.2020 - 30.06.2021	58v 6m	35				
01.07.2021 - 30.06.2022	59v	35				

01.07.2022 - 30.06.2023	59v 6m	35
2023 e në vazhdim	60v	35

I siguruari ka të drejtë të marrë pension pleqërie në kushtet e kategorisë së parë ose asaj të dytë pasi të ketë plotësuar në këtë kategori jo më pak se 3/4 e viteve të sigurimit. I siguruari që ka plotësuar vitet e sigurimit sipas tabelës së mësipërme, nga të cilat jo më pak se 1/2 e ka punë në nëntokë, ka të drejtë të marrë pension në kushtet e kategorisë së parë.”

Neni 9

Neni 95 ndryshohet si vijon:

"Neni 95 Pensioni i pjesshëm

Mosha dhe periudha e sigurimit për pension të pjesshëm pleqërie, deri në arritjen e moshës dhe plotësimin e periudhës së sigurimit, që përcaktohen në nenin 34 të ligjit, rriten sipas tabelës që vijon:

MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRKOHEN NË VITE PËR PËRFITIMIN E PENSIONIT TË PJESSHËM TË PLEQËRISË

Vitet	Mosha për burrat	Vitet e sigurimit për burrat	Mosha për gratë	Vitet e sigurimit për gratë
1993	60	12v 6m	55	10v
1994	60	12v 6m	55	10v 6m
1995	60	13v	55	11v
1996	60	13v 6m	55	11v 6m
1997	60	14v	55	12v
1998	60	14v 6m	55	12v 6m
1999	60	15v	55	14v
2000	60	15v 6m	55	15v
2001	60	16v	55	16v
01.07.2002 - 30.06.2003	60v 6m	17v	55v 6m	17v
01.07.2003 - 30.06.2004	61v	18v 6m	56v	18v 6m
01.07.2004 - 30.06.2005	61v 6m	20 v	56v 6m	20v
01.07.2005 - 30.06.2006	62v	20 v	57v	20v
01.07.2006 - 30.06.2007	62v 6m	20 v	57v 6m	20v
01.07.2007 - 30.06.2008	63v	20 v	58v	20v
01.07.2008 - 30.06.2009	63v 6m	20 v	58v 6m	20v
01.07.2009 - 30.06.2010	64v	20 v	59v	20v
01.07.2010 - 30.06.2011	64v 6m	20 v	59v 6m	20v
2011 e në vazhdim	65v	20 v	60v	20v

Pensioni i pjesshëm jepet në raport me vjetërsinë në punë që kërkohet në vitin përkatës."

Neni 10

Në nenin 97 paragrafi i tretë pas shprehjes "Me arritjen e moshës së pensionit" shtohen fjalët "sipas nenit 92".

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi më 1 korrik 2002.

Shpallur me dekretin nr. 3323, datë 14.5.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 194, datë 9.5.2002

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike dhe të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS PËR HEQJEN E VIZAVE NGA PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Kabineti i Ministrave të Ukrainës dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si Palët,

Duke dëshiruar të lehtësojnë, në mënyrë të ndërsjellë, hyrjen, daljen dhe lëvizjen e qytetarëve të tyre.

Kanë rënë dakort sa më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e Shtetit të secilës Palë, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, kanë të drejtë të hyjnë, dalin dhe të kalojnë tranzit nëpër territorin e Shtetit të Palës tjetër pa viza.

Me mbërritjen atyre u garantohet e drejta të qëndrojnë në territorin e Shtetit të Palës tjetër, për një periudhë deri në nëntëdhjetë (90) ditë.

Neni 2

Anëtarët e përfaqësive diplomatike ose misionëve konsullorë dhe organizatave ndërkombëtare, të akredituar në territoret e Shteteve Palë kanë të drejtë të hyjnë, dalin ose qëndrojnë në territoret e Shteteve Palë pa viza gjatë gjithë periudhës së akreditimit. Kjo klauzolë, gjithashtu,

zbatohet për anëtarët e familjeve të diplomatëve dhe përfaqësuesve konsullorë, që janë mbajtës së pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.

Neni 3

Hyrja dhe dalja e shtetasve të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit në territorin e Palës tjetër duhet të kryhet në pikat e kontrollit për lëvizjen e pasagjerëve të huaj.

Neni 4

Kjo Marrëveshje nuk i përjashton shtetasit e Shteteve të secilës Palë, që janë mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, nga detyrimi për të respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e Shtetit pritës.

Në anën tjetër, kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtën e të dy Palëve të refuzojnë hyrjen ose të ndalojnë qëndrimin e shtetasve të Palës tjetër në territorin e vet, nëse ata kryejnë akte që shkelin legjislacionin e shtetit pritës.

Neni 5

Palët do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike specimenet e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit tridhjetë (30) ditë përpara se kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi.

Palët do të informojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike për hyrjen në qarkullim të pasaportave të reja, ose ndryshimet në dokumentet e vlefshme dhe do të shkëmbejnë specimet e këtyre pasaportave, përpara gjashtëdhjetë (60) ditëve nga fillimi i përdorimit të pasaportave të reja ose ndryshimet në pasaporta.

Neni 6

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe shtohet me marrëveshje ndërmjet Palëve. Ajo formalizohet me protokolle të veçanta, që përbëjnë pjesën thelbësore të kësaj Marrëveshje.

Neni 7

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e gjashtëdhjetë (60), pasi Palët të njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore, të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.

Secila Palë mund të ndërpresë vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje, pasi të ketë njoftuar për këtë Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, Marrëveshja do të shfuqizohet nëntëdhjetë ditë pas ditës në të cilën Pala tjetër ka marrë njoftimin.

Bërë në Tiranë, më 19. 4. 2002 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, ukrainase dhe angleze.

Në rast kontradiktash për interpretimin e teksteve në gjuhët ukrainase dhe shqipe, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

Për Qeverinë e Republikës
të Shqipërisë

Për Kabinetin e Ministrave
të Ukrainës

V E N D I M **Nr. 195, datë 9.5.2002**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 30, DATË 28.1.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR KRITERET E ZGJEDHJES DHE RREGULLIMIN E
MARRËDHËNIEVE TË SHOQËRIVE QË DO TË NDËRTOJNË DHE PËRDORIN
INSTALIME BREGDETARE PËR TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTËS,**

GAZIT DHE TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE".

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës gazit dhe nënprodukteve të tyre", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.30, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

Emërtimi "Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit" zëvendësohet me "Ministria e Industrisë dhe Energjetikës"; emërtimi "Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit" zëvendësohet me "Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit"; emërtimi "Ministria e Transportit" zëvendësohet me "Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit"; emërtimi "Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë" zëvendësohet me "Ministria e Ekonomisë".

2. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 196, datë 9.5.2002

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 510, DATË 24.11.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "MBI KRITERET E VENDOSJES NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE DHE DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR PRANIM"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 37 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", ndryshuar me ligjet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.510, datë 24.11.1997 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Dokumentet e noterizuara të pronësisë së banesës së fëmijës, kur prindërit kanë vdekur, dhe dokumente të tjera të të drejtave pasurore të fëmijës, kur është trashëgimtar".

2. Në pikën 3 bëhen shtesat si më poshtë vijon:

- Në shkronjën "a" pas fjalës "...mendore..." shtohet shprehja "... që kanë mundësi zhvillimi...".

- Në shkronjën "b" pas fjalës "...fizike..." shtohet shprehja "... që kanë mundësi zhvillimi...".

- Në shkronjën "c" pas fjalës "...sensore..." shtohet shprehja "... që kanë mundësi zhvillimi...".

- Pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç. Kanë përparësi individët e moshave 4 -16...

- Koha e qëndrimit në institucion është deri në 5 vjet. Bëjnë përjashtim fëmijët që janë jetimë".

- Pas shkronjës "d" shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Komisioni vendor për pranimin, në raste të veçanta, edhe të individëve që nuk plotësojnë kërkesat e shkronjave "a", "b", "c", si dhe për zgjatjen e afatit të qëndrimit në institucion".

3. Në pikën 5 të bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:
Afati "...deri në 1 muaj" zëvendësohet me "...deri në 15 ditë...".

4. Pika 8 riformulohet si më poshtë vijon:

"8. Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranimin, të përcaktuara në këtë vendim, janë të detyrueshme për të gjitha institucionet publike të përkujdesjes shoqërore, të drejtuara në nivel qendror e vendor. Këto kriteret, për institucionet private të përkujdesjes shoqërore, janë orientuese. Kriteret e veçanta për to përcaktohen në rregullore, të miratuara nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 197, datë 9.5.2002

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT
DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT DHE ATO SPECIALE NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike, të shërbimit dhe ato speciale ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
ARABE TË EGJIPTIT MBI HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE, TË
SHËRBIMIT DHE SPECIALE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Arabe të Egjiptit,
Duke dëshiruar të lehtësojnë hyrjen, daljen dhe lëvizjen e shtetasve të tyre midis të dy vendeve,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për pasaportat e mëposhtme:
për Republikën e Shqipërisë – pasaportat diplomatike dhe të shërbimit;
për Republikën Arabe të Egjiptit – pasaportat diplomatike, të shërbimit dhe speciale.
Shtetasit e secilit vend, mbajtës të pasaportave diplomatike, speciale dhe të shërbimit, kanë të drejtë të hyjnë, dalin ose të kalojnë tranzit në territorin e shtetit tjetër pa viza.
Atyre u jepet, me të mbërritur, një leje qëndrimi prej 90 ditësh.

Neni 2

Anëtarët e misionëve diplomatike ose konsullore dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në secilin vend, ashtu si edhe anëtarët e familjeve të tyre, mbajtës të pasaportave diplomatike, speciale dhe të shërbimit, kanë të drejtë të hyjnë në territorin e vendit tjetër pa vizë.

Neni 3

Hyrja dhe dalja e shtetasve të të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike speciale dhe të shërbimit, në territorin e shtetit tjetër duhet të bëhen nëpërmjet pikave zyrtare të hyrjes të të dy vendeve.

Neni 4

Kjo Marrëveshje nuk i përjashton shtetasit e të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike, shërbimit dhe speciale, nga detyrimet për të respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vendit tjetër.

Nga ana tjetër, i jep secilit vend të drejtën për të refuzuar hyrjen dhe/ ose të anulojë qëndrimin e shtetasve të vendit tjetër drejt/në territorin e tij nëse ata kryejnë akte që shkelin të tilla ligje dhe/ose rregulla.

Neni 5

Kjo Marrëveshje nuk ndikon mbi ligjet dhe/ ose rregullat e karakterit të përgjithshëm që janë në fuqi në të dy vendet në lidhje me sigurimin e brendshëm dhe atyre që organizojnë hyrjen, qëndrimin dhe lëvizjen e të huajve.

Neni 6

Palët do të shkëmbejnë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, specimene të pasaportave diplomatike, speciale dhe të shërbimit.

Ato do të informojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim që do t'u ndodhë këtyre pasaportave, 60 ditë përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve.

Neni 7

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën kur do të shkëmbehen notat diplomatike që tregojnë plotësimin e procedurave ligjore nga Palët përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi përderisa asnjë nga Palët të mos informojë Palën tjetër me shkrim tre muaj paraprakisht për vendimin e saj për të përfunduar atë.

Bërë në Kajro, më 2.4.2002 në dy kopje origjinale në gjuhët shqip, arabisht dhe anglisht. Në rast mosmarrëveshjesh në interpretim do të vlejë teksti në anglisht.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT

V E N D I M
Nr. 199, datë 9.5.2002

**PËR MIRATIMIN E ANEKSKONTRATËS PËR HIDROCENTRALIN E SMOKTHINËS
NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË
ITALIANE “ESSEGEI”, S.R.L.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7970, datë 20.7.1995 “Për rregullimin e energjisë elektrike” dhe të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e anekskontratës për hidrocentralin e Smokthinës ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë italiane “Essegei”, s.r.l, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Monitorimi i zbatimit të kësaj anekskontrate të bëhet nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës.

3. Në vendimin nr. 445, datë 17.6.2001 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kontratës koncesionare të formës “ROT” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë italiane “ESSEGEI”, s.r.l, për hidrocentralin e Smokthinës” të bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1, emërtimi “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohet me “Ministria e Industrisë dhe Energjetikës”.

- Në pikën 2, emërtimi “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohet me “Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**

ANEKSKONTRATË

**MIDIS MINISTRISË SË INDUSTRIISË DHE ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI I INDUSTRIISË DHE ENERGJETIKËS Z.VIKTOR DODA**

Dhe

Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës italiane “ESSEGEI” s.r.l., me zyrë në Romë Itali, në adresën Rruga: Adda 21, 00918 Romë, që më pas do t’i referohemi si “Koncesionari” dhe përfaqësuar nga Presidenti z.Vicenzo Marco Jorio.

Meqenëse ekzistojnë këto kushte paraprake:

- Essegei-Shqipëri sh.p.k., shoqëri e krijuar nga Koncesionari në bazë të legjislacionit shqiptar (këtu e më poshtë, “Essegei Shqipëri”), që nga gushti i vitit të kaluar është duke i dhënë energji KESH-it në rrjetin e H/C, pa ndonjë ndalesë të rëndësishme, pavarësisht nga sezoni dhe mungesa e ujit.

- Mungesa e një marrëveshjeje juridike afatgjatë blerjeje për fuqinë që do të bëhet e vlefshme dhe për furnizimin e energjisë.

- Realizimi i Kontratës së Koncesionit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 17.6.2001.

- Mundësia e fuqizimit të bashkëpunimit për realizimin e plotë të Projektit.

- Kuadri ligjor për problemet e regjimit të ujrave për H/C e Smokthinës është i kompletuar, veçanërisht në bazë të ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999 dhe ligjit 8605 datë 20.4.2000.

Si dhe baza ligjore:

- Ligjin nr. 7970, datë 20.6.1995 “Mbi rregullimin e energjisë elektrike”.

- Ligjin nr. 7973, datë 26.6.1995 “Mbi koncesionet në sektorin privat në shërbimin publik dhe infrastrukturë”.

- Neni nr. 22 i Kontratës së Koncesionit të bërë në mes Palëve dhe të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 17.6.2001.

Palët ranë dakord si më poshtë:

Në nenin 7 të Kontratës së Koncesionit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 17.6.2001, pas paragrafit të fundit shtojnë një paragraf tjetër me këtë përmbajtje:

“Me miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga ERE (Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike), autorizohet KESH sh.a. të lidhë kontratë me Koncesionarin dhe me ESSEGEI-SHQIPËRI sh.p.k. për pagimin e energjisë elektrike të konsumuar nga KESH sh.a. dhe të dhënë nga shoqëria ESSEGEI-SHQIPËRI sh.p.k. e krijuar nga Koncesionari dhe për të lidhur kontratë afatgjatë për blerjen e energjisë elektrike nga Koncesionari dhe shoqëria ESSEGEI-SHQIPËRI sh.p.k.

Kjo Anekskontratë hyn në fuqi me miratimin nga Këshilli i Ministrave.

Kjo Anekskontratë u përpilua në 6 kopje dhe u nënshkrua nga Palët pa asnjë vërejtje.

Adresat dhe fakset zyrtare që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Kontrate janë të njëjta me Kontratën e Koncesionit.

Nënshkruar nga

Për OSHA

Ministër i Industrisë dhe Energjetikës

Viktor Doda

Për Koncesionarin

ESSEGEI sh.p.k.

Vincenzo Marco Jorio

V E N D I M **Nr. 205, datë 9.5.2002**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 384, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NË PUNË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 98 dhe 99 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 384, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e të miturve në punë” të bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 3 shkronja “B” ndryshon si më poshtë vijon:

“Të miturit nën moshën 14 vjeç mund të jenë subjekte të formimit profesional, me autorizim të Inspektoratit Shtetëror të Punës”...

2. Pika 5/b e shkronjës “D” ndryshon, si më poshtë vijon:

“b) nënkupton një ekspozim të dëmshëm ndaj agjentëve fizikë, biologjikë dhe kimikë, të përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

3. Paragrafi i fundit në pikën 5/d të shkronjës “D” ndryshon si më poshtë vijon:

“Për punëmarrësin nën 18 vjeç, kohëzgjatja ditore e punës është jo më shumë se 6 orë në ditë. Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është të paktën 4 javë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LISTA E PUNËVE TË VËSHTIRA OSE TË RREZIKSHME, ME EKSPOZIM TË DËMSHËM
NDAJ AGJENTËVE FIZIKË, BIOLOGJIKË DHE KIMIKË PËR TË MITURIT NËN 18 VJEÇ

Janë punë të vështira ose të rrezikshme, me ekspozim të dëmshëm ndaj agjentëve fizikë, biologjikë dhe kimikë për të miturit nën 18 vjeç, punët e mëposhtme:

1. punët në prodhimin, përpunimin dhe përdorimin e lëndëve shpërthyes, gazrave të djegshme, lëndëve toksike, lëndëve kancerogjene etj;
2. punët gjatë të cilave punëmarrësi ekspozohet ndaj:
 - rrezeve jodizuese, që përmbajnë doza më të larta nga të lejueshme;
 - zhurmave me mbi 85 decibel në punë statike, si dhe zhurmave me mbi 140 decibel, në punët e çastit;
 - temperaturave tepër të larta ose të ulëta, për një farë kohe, si dhe në nxehtësi të lartë rrezatuese;
 - kushteve të këqija atmosferike për kryerjen e punëve urgjente.
3. punët gjatë të cilave punëmarrësi detyrohet të mbajë qëndrim jo të rregullt ose të përdorë pjesë të trupit për një kohë të gjatë në pozicion të detyruar;
4. punët ku përdoren lëndët që çlirojnë dioksid të lirë të piritit ose kripëra të përbëra të piritit dhe të amiantit;
5. punët për prodhimin, përpunimin e ngjyrave me përbërje karboni;
6. punët në përdorimin e tretësve që përbëjnë benzol;
7. në punët për djegien e mbeturinave dhe groposjen e tyre;
8. punët në të cilat prodhohen ngjitësa, si dhe në depot ku bëhet regjia e lëkurëve;
9. në punët ku bëhen kopanisja, shkrifërimi, tjerja e pambukut ose e leshit;
10. punët në shtypshkronjë;
11. punët në prodhimin dhe përpunimin e qelqit, si prerje, lëmim etj;
12. punët në lyerjen me pistoletë, si punë sistematike, si dhe në lyerjen e pjesëve metalike;
13. puna në uzina dhe laboratorë, që prodhojnë dhe përpunojnë:
 - acide;
 - kripëra të klorit;
 - anilinë dhe ngjyruet me anilinë dhe azot;
 - fosfor;
 - plehëra kimike.
14. punët në zbardhjen dhe tretjen e letrës;
15. punët në industrinë metalurgjike;
16. punët në fabrikat e blojës (në repartet ku ka shumë pluhura);
17. puna në uzinat dhe laboratorët ku prodhohen ose përpunohen:
 - lëndët shpërthyes;
 - fishekzjarret;
 - gazet ndriçuese, lëndët ndezëse ose aty ku ngrihen pluhura, që paraqesin rrezik shpërthimi.
18. punët në bodrume;
19. saldimet, prerjet me oksigjen ose elektricitet, përveçse kur zbatohen programe të formimit profesional;
20. punët ku përdoren makinat lëvizëse;
21. punët ku përdoren vinçat;
22. punët ku përdoren presat hidraulike;
23. punët me makineri, që kanë mjete prerëse, të cilat lëvizin me forcë mekanike dhe veçanërisht:
 - punimet me sharrë hark, sharra kordele, makinat e lëmimit të drurit;
 - punimet me gërshërë në makinë prerëse;
 - punimet në makineritë që punojnë me cilindra dhe që rrezikojnë kapjen e pjesëve të të ndryshme të trupit.
24. në punimet me enët në tryzni;
25. punët në pastrimin, riparimin dhe kërkimin e defektit të makinerive dhe të mjeteve në lëvizje;

26. punët për shtypjen e butonave që transmetojnë lëvizje dhe ndal punën e maqinerive;
27. punët për mirëmbajtjen e maqinerive, të pajisjeve elektrike dhe të ndërtesave;
28. punët për vrojtimin e sigurisë në punë, ndërlidhjen dhe bashkëveprimin e punëtorit, që e kryen një punë me punonjës të tjerë, të cilët kryejnë një punë tjetër;
29. punët në nëntokë;
30. punët në të cilat përdoren maqineritë e ndërtimit;
31. punët për shkatërrimin e objekteve të ndërtimit;
32. punët për ndërtimin e kolonave dhe të mureve brenda në ujë, si dhe në shqepjen e kolonave;
33. punët për përdorimin e pajisjeve elektrike të tensionit të lartë; puna në objekte me tension më të lartë se 50 volt;
34. punët nënujore, që kryhen me skafandër apo me aparat frymëmarrjeje;
35. punët për ngarkimin dhe shkarkimin e anijeve, përveç skafeve të vegjël, që kanë gjatësinë më pak se 12 m dhe gjerësinë më pak se 4 m;
36. punët në vendet me rrezik rënieje, nga lartësia 3 m, edhe sikur të jetë bërë sigurimi me litar shpëtimi ose të jenë marrë masa të tjera;
Ndalimi nuk ekziston vetëm nëse ka rrethim mbrojtës në çdo vend pune.
37. punët, ku ka rrezik rënieje materialesh në vendin e punës, ku lëviz punëmarrësi;
38. punët me maqineritë e shpimit;
39. punët me pistoletë për mbërthim-zbërthimin e vidave dhe bulonave;
40. punët për prerjen e lëndëve drusore me makina elektrike;
41. punimet në degëzimet e linjave të trenave dhe ku punëmarrësi merr pjesë në lidhjen e vagonëve;
42. punët për pastrimin dhe lyerjen me pistoletë me trysni mbi 2.5 atmosferë;
43. punët për fryrjen e gomave të autobusëve, makinave, aeroplanëve me trysni mbi 3 atmosferë;
44. punët si shoqërues në transportin e fondeve monetare për në bankë apo agjenci bankare dhe anasjelltas;
45. punët për kërkime ndaj kancerit dhe sëmundjeve ngjitëse;
46. punët në vendet ku ka mungesë oksigjeni ose ekziston një atmosferë e rrezikshme (lëndë helmuese ose shpërthyes).

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 16. 5. 2002
Doli nga shtypi më 17. 5. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë